



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr. 101 Datë 16.11.2020

**Agjencia e Prokurimit
Publik
Blv "Dëshmorët e Kombit"
Tel: + 355 4 2277510
e-mail:
info.app@app.gov.al
<https://www.app.gov.al>**



- Diplomë master pasuniversitar të fushës;
- Kualifikime pasuniversitare të fushës.
- Përvojë pune 3 vitet e fundit pa shkëputje në mësimdhënien e gjuhës gjermane në rang universitar

Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

- 1.Dokument identifikimi
- 2.Curriculum vitae
- 3.Kërkesë me shkrim
- 4.Fotokopje e diplomës, e noterizuar
- 5.Fotokopje e listës së notave, e noterizuar
- 6.Dëshmitë për titujt dhe gradat shkencore (të noteruar)
- 7.Dëshmitë për kualifikimet dhe aktivitetet lidhur me temën e aplikimit.
- 8.Vlerësim të punëdhënësit nëse kandidati ka qenë i punësuar më parë.
- 9.Në rast të përfundimit të studimeve jashtë vendit kandidati do të paraqesë edhe ekuivalentimin e Diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës(të noteruar)
- 10.Dëshmi penaliteti
- 11.Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë

Shqyrtimi i dosjes do të bëhet nga komisionit i vlerësimit. Kandidati do t'i nënshtrohet një interviste para komisionit të vlerësimit.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data 16 – 27.11.2020

Për cdo sqarim mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042452610

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Ne zbatim të Programit të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për aplikimin në Programet e Nxitjes së Punësimit, AKPA në Buletin Nr.59, date 24.08.2020 ka njoftuar ne lidhje me fillimin e aplikimeve në Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2020 .

Në zbatim të VKM 348, datë 29.04.2020 për “Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, nëpërmjet vetëpunësimit”, Kreu III. “Rregullat dhe procedurat për përfitimin e programit të vetëpunësimit” pika 1, AKPA nëpërmjet Strukturave të saj, hap shpalljen e thirrjes ku fton të gjithë pupa e rregjistruar në Zyrat Vendore të Punësimit të cilët kanë një ide biznesi të marrin pjesë në këtë konkurim i cili në fazën e parë do të pilotohet në 4 rajone me një numër të kufizuar përfituesish (rreth 50 pu.pa.) në Rajonet si më poshtë:

Tiranë 30 (tridhjetë) pu.pa

Shkodër 10 (dhjetë) pu.pa

Kukës 5 (pesë) pu.pa

Dibër 5 (pesë) pu.pa

Për sqarim:

Programi i vetëpunësimit është program njëvjeçar për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, nëpërmjet të cilit ofrohet trajnim për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grant për përfituesit.

Fondi i nxitjes së punësimit për programin sipas pikës 1, të këtij kreu, mbulon shpenzimet për: a) grantin për hapjen e biznesit të ri; b) vlerësimin e planeve të biznesit

1. Për të aplikuar në këtë program, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) Është punëkërkuar i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit;
- b) Ka një ide biznesi, e cila nuk është në kundërshtim me kriteret e konkurrencës, të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Punës dhe që deklarohet në bazë të një formulari të posaçëm, Afati për të aplikuar në program, për të gjithë punëkërkuarët e papunë, është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e publikimit të thirrjes.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, shkresës së KLGJ-së me nr. 1671 prot., datë 09.03.2020, me lëndë: “Mbi miratimin e shtesës në organikën e gjykatës”, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të skualifikimit të kandidatëve të cilët paraqitën kërkesat e tyre nga njoftimi i mëparshëm, por dokumentacioni i tyre rezultoi i paplotë, gjë që solli skualifikimin që në fazën e parë bëjmë këtë njoftim për rishpalljen e konkurrimit për 2(dy) vende të lira pune, si më poshtë:

- Për 2 (dy) vende, në pozicionin nëpunës gjyqësor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Kërkesa të përgjithshme, kandidati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit nr. 55, të Ligjit nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Nëpunësi gjyqësor është subjekt procedural dhe përmbush detyrat procedurale në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin nëpunës gjyqësor, janë si më poshtë:

- Nëpunësi gjyqësor në kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me sekretarin gjyqësor dhe sekretarin e seancës. Ai i dorëzon sekretarit gjyqësor përkatës aktet e njoftimit përpara datës së përcaktuar për seancën gjyqësore;
- Nëpunësi gjyqësor duhet të marrë pjesë në seancën gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhërave të gjykatës për njoftimin dhe futjen në sallë të dëshmitareve, ekspertëve dhe kërkon nga ata solemnitet e respektim të trupit gjykues.
- Orienton palet të vendosen para gjykatës.
- Njofton aktet me shkrim, telefon e kundrejt firmes së marresit, kur është e mundur, dëshmitaret, ekspertët etj, sipas menyres së përcaktuar në procedurën civile e penale, dhe, në rast, tregon kujdes për eliminimin e shkaqeve të pavlefshmerisë së njoftimeve e të akteve. Aktet e njoftuara para datës së caktuar për seancën gjyqësore i dorëzon të sekretarit seances përkatës.
- Bashkëpunon me sekretarët gjyqësorë për zhvillimin e proceseve, për përgatitjen e dokumenteve, vërtetimeve, njoftimeve dhe akteve të tjera të kërkuara prej tyre, si edhe, kur nevojitet, përgatit kopje të dokumenteve dhe bashkëlidhje të dosjeve;
- Siguron kushtet e sallës së gjyqimit që do të përdoret, si edhe rregullin brenda saj, etj.